



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 13.12.2023
NR.09/ 10392 /2023

KONTRATË FURNIZIMI

Numri i kontratës ¹: 659-23-12571-1-3-6/C493: KKHE-23-065-1-3-6

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
MADEKOS SH.P.K., Vragoli (Magjistratja Prishtinë-Pejë), Fushë Kosovë, (në vazhdim "Furnizuesi"), në
anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:
Furnizim me medikamente për QKMF- Hani i Elezit me numër identifikues: 659-23-12571-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim** nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizim me medikamente për QKMF- Hani i Elezit

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 3 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë QKMF-Hani i Elezit.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë për Furnizimin.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 9,961.50 €; [Nëntë mijë e Nëntëqindë e Gjashtëdhjetë e Një/50 cent] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kjo marrëveshje e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare;

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën SHQIPE³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	KHEVDET BUSHI
Pozita:	SHF 1 Zëritës i Pranimi
Nënshkrimi:	
Data:	13.12.2023
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Ardian Buzuku
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	13.12.2023
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-23-12571-1-3-6/C493

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	9.1	10% e vleres së kontratës për 13 muaj
Sigurimi	10.1	Sigurimi i ekzekutimit
Programi i ekzekutimit	11	<i>Sipas kërkesës së Njesisë kerkuese, jo më vonë se 3 ditë nga data e porosisë të bëhet furnizimi dhe medikamentet duhet të ketë afat min. 6 muaj nga data e pranimit.</i>
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	<i>Te gjitha taksat janë përgjegjësi e furnizuesit</i>
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Furnizimet duhet të jenë konform cilësive së pranimit</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<i>Komisioni i pranimit do të inspektoj furnizimet dhe do të testoj</i>
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet jo më vonë se 30 ditë pas pranimit të faturës nga ana e AK-së (nenshkrimet të faturës)
Dorëzimi	21.3	<i>3 ditë pas kërkesës</i>
Obligimet e garancionit	24.1	<i>6 muaj minimum afat duhet të kenë medikamentet</i>
Shërbimet pas shitjes	25.1	<i>[Jepni detajet e shërbimit pas shitjes që Furnizuesi duhet të sigurojë dhe përcaktoj raportin e sigurisë së ekzekutimit të caktuar për këtë aktivitet]</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<i>Menaxheri - Njesia kerkuese - Zyra e Prokurimit</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	<i>[Shëno të dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore Ferizaj – Dega Kaçanik në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i>.